

# KOSOVARIA

Ballina: Aida Troka &  
Edisa Dece  
Foto: Ergys Zhabjaku  
Makeup: Ujvara Hajdari

A ka njeri  
në Kosovë  
që nuk merret  
me politikë

A na ka  
nemur kush  
apo e kemi  
nemur veten

Çka i tha  
Klintonit gjyshja  
e Kaltrina Selimit

*Aida Troka e Edisa Dece,  
dy femrat që zbuluan sekretin  
e rinisë së përjetshme*

Valentina  
Rexhaj  
ndër gratë  
më të  
fuqishme

Kosova –  
maden  
i vajzave  
të bukura

Para  
gruas sime  
veshët  
më palosen

UB  
me anëtarët  
e rrethit Bonn/  
Rein-Sieg





**DINO**  
QERAMIKA

AKSION në  
**DINO**  
QERAMIKA

nga  
1 Qershor  
deri  
15 Qershor

**50%**

zbritje në artikuj të caktuar!

---

# Aida Troka e Edisa Dece, **dy femrat që zbuluan** sekretin e rinisë së përjetshme

*Aida Troka dhe Edisa Dece janë dy femra të forta, profesioniste të zonja dhe shembuj perfekt se si bashkimi bën fuqinë. Krahe tyre është edhe simboli i femrës së jashtëzakonshme, e që shkëlqen kudo, Arbnora Ademaj. Me dëshirën për të bërë më të mirën dhe për të sjellë shërbimet më ekskluzive e inovative në fushën mjekësisë estetike, Aida e Edisa, e pranë tyre edhe Arbnora, ngritën atë që sot njihet si “Perandoria e bukurisë”, klinikën e mjekësisë estetike “Allure Beauty”. Për atë se si dy femra të zonja u bënë pronare të një biznesi, e që sot është brend në fushën e së bukurës, cilat janë të veçantat dhe shërbimet në “Allure” që gjendet në Tiranë dhe për klientelen e gjerë, lexoni veç në “Kosovare”...*





### Jeni dy mike që keni klinikë estetike. Si u njohët?

**Aida:** - Takimi ynë ka qenë rastësi. Ose, ndryshe, disa gjëra ndodhin për një arsye. Unë kisha disa kohë që kërkoja pajisjen "Plexer", pasi kisha dëgjuar që eliminonte çdo rrudhë në lëkurë, e Edisa ishte e vetmja mjekë në Shqipëri që kishte ndjekur trajnimet e "Plexer", nga vetë krijuesi i kësaj aparature.

**Edisa:** - Më kishin thënë se Aida ishte një vajzë shumë e njohur në Tiranë dhe mjaft punëtore. Në atë kohë Aida menaxhonte një klinikë mjekësore në Tiranë dhe ishte një nga ata njerëz që e kishe mjaft të thjeshtë të flisje e të ndaje njohuri mjekësore, aq sa të krijonte përshtypjen se po flisje me një mjek.

### Cilat ishin impresionet e para dhe a mendonit se një ditë mund të jeni bashkëpunëtore kaq të afërta?

**Aida:** - Që në takimet tona të para jam mrekulluar nga njo-

huritë mjekësore të Edisë. Ndryshe nga shumë mjekë të tjerë, Edisa kishte informacion për çdo gjë! Shkollimi në Greqi dhe specializimet në Gjermani e Angli e kishin kompletuar në këtë fushë.

### Aida dhe Edisa, nga miqësia lindi edhe biznesi. Mund të na flisni për klinikën tuaj?

**Aida:** - Në fakt, ishte ideja e Edisë që ne të hapnim një klinikë mjekësore dhe kështu u krijua "Allure Beauty". Donim të sillnim diçka ndryshe nga ato që kishte në Shqipëri në ato kohë. Klinikat ishin të fokusuar tek shërbimet e ekzagjuruara, sepse atë kërkonin edhe vetë njerëzit, ndërkohë që "Allure" u krijua për të sjellë çdo risi të botës në Shqipëri.

Të ecnim me hapin e shkencës dhe jo të prisnim dekada për të ardhur në Shqipëri - ky ishte synimi ynë kryesor.

Ne dhe klinika "Allure Beauty"

kemi si synim kryesor të sjellim në Shqipëri dhe në rajon çdo produkt të shëndetshëm, që e bën trupin sa më të shëndetshëm.

Fokusi ynë është në stimulimin e prodhimit të qelizave të reja në trup. E, nëse ne realizojmë këtë, automatikisht trupi jonë nuk plaket.

### Ku dhe në çka më tepër është e përqendruar klinika juaj estetike?

- "Allure Beauty" është krijuar për të ndihmuar çdo kë që të ketë lëkurën, fytyrën, trupin e shumë dëshiruar. Por, e gjitha kjo në mënyrën më të shëndetshme dhe natyrale.

Çdo pajisje apo produkt në "Allure" ndihmon në rigjenerimin e qelizave dhe stimulimin e prodhimit të tyre.

Fjala "rini" nuk do të thotë të jesh gjithmonë 20 vjeç... Por, nëse ti e realizon gjithmonë stimulimin dhe prodhimin e qelizave të reja në trupin tënd, si rrjedhojë edhe ti je i shëndetshëm, aktiv, plot jetë, e atëherë lëkura jote shkëlqen.

Pra, ke gjithçka që përkufizohet me fjalën të qenit i ri...

### Me çfarë produktesh punoni dhe në çfarë niveli është shkalla e efikasitetit të shërbimeve?

- Jemi të dashuruara me kulturën koreane të përkujdesjes së lëkurës. "Allure Beauty" ka sjellë në Shqipëri produktet koreane, kur ato nuk njiheshin në Shqipëri. Madje, shpeshherë njerëzit i ngatërronin për kineze, sepse kultura koreane e kujdesit të lëkurës nuk ishte e njohur në atë kohë te ne. "Allure Beauty" solli mezoterapitë më të mira dhe më të shëndet-

shme me formula komplete. "Jamber" sustat e kolagenit çudibërëse dhe 4 linjat e përku-jdesjes së lëkurës, janë produkte koreane. Fabrika që prodhon linjat e kremrave është fabrika nr. 1 në botë për lëndën e parë dhe furnizon gjithë kompanitë ndërkombëtare me lëndën e parë, përfshirë dhe "La praire". Pastaj, krijoj dhe katër linjat e veta.

### **Mund të na flisni pak më tepër për procedurën "Jamber": Çka është, si realizohet dhe pse rekomandohet?**

- Është një procedurë më se e thjeshtë, pa dhimbje dhe që realizohet në një minutash shumë të shkurtër, ndërkohë që rezultatin e ka të menjëhershëm dhe që zgjat për pesë vjet.

Pas realizimi të procedurës nuk ka nevojë të shkëputeni nga puna, pasi menjëherë mund t'i ktheheni aktiviteteve të përditshme.

### **Duket se tendenca është "rinia e përjetshme" dhe perfeksioni në çdo detaj. A e kanë kaq të rëndësishme femrat këtë gjë?**

- Rinia për femrat është një ndër gjërat më të rëndësishme, sidomos kur e rifitojnë në një moment që ndihen të pashpresa. Gjithsesi, kush nuk do donte të ishte gjithmonë një "Piter Pan"? Ndoshta vitet nuk i zvogëlojmë dot, ama lëkurën mund ta bëjmë të shkëlqejë dhe të tregojë rini të përjetshme...

### **A ka personazhe të famshëm që vijnë në klinikën tuaj?**

- Ka shumë personazhe të famshëm që ia kanë besuar pamjen e tyre "Allure Beauty". Puna me vajzat e famshme është mjaft e veçantë,



por edhe përgjegjësi e madhe. Gjithsesi, fatmirësisht, asnjë prej tyre nuk është tekanjoze, për më tepër që gjithmonë dalin nga klinika të kënaqura me rezultatin që kishin dashur.

### **Gjithsesi, besojmë se ka një shërbim që e identifikon klinikën "Allure Beauty"?**

- Klinika "Allure" ka futur në treg aparaturat më profesionale, por do të veçoja shërbimin "Plexer". Të rifitosh rininë tënde në një moshë të madhe, mendoj se është dhurata më e bukur që mund t'i bësh vetes apo grave të zemrës.

### **A është sfiduese të qenit femër në biznes?**

- Të jesh femër në biznes duhet të jesh shumë e fortë. Aq më tepër në një vend si Shqipëria apo rajoni, ku duket dukshëm që meshkujt triumfojnë. Gjithsesi, gjinia nuk mund të të

penalizojë për atë çka ti dëshiron të arrish në jetë...

### **Aida dhe Edisa, a ka një formulë suksesi që mund të na zbuloni?**

- Formula e suksesit është e thjeshtë: Të duash punën që ti bën! Teksa ke pasionin dhe dëshirën për të sjellë risi në Shqipëri e rajon, gjithçka mund të realizohet me sukses. Gjithashtu, një peshë të madhe në sukses kanë edhe bashkëpunëtorët tanë të kualifikuar.

### **Diçka që ka mbetur pa u thënë?**

- Duhet ta vizitoni me patjetër "Allure Beauty", sepse, siç thotë shprehja e famshme, "një herë ta provoni, gjithmonë do ta kërkonit!". Gjithashtu, faleminderit të gjithë njerëzve që besuan te ne që nga fillimi e deri më sot!

**Nderim Neziri**

# A ka njeri në Kosovë që nuk merret me politikë?

*Politizimi jetës në Kosovë ka arritur kulmin, por brengosin më shumë numri i madh i vrasjeve, i dhunës në familje, i sulmeve fizike, e të tjera të ngjashme. Por, edhe marrja me politikë ka arritur kulmin!*

## NA E QITËN FLAKËN DEBATET POLITIKE!

“Është evidente se pjesa më e madhe e shoqërisë kosovare merret me politikë. Numri më i madh i tyre mendon se janë politizuar nëpërmjet debateve të ndryshme politike në televizionet tona, por edhe nga portalet e shumta që janë Kosovë, Shqipëri e gjatë ku ka shqiptarë”, thotë Naim Hasani, kamerier në njërin nga lokalet e Prishtinës, i cili, edhe pse i kritikon ata që merren me politikë, edhe vetë shihet se është i flaktë pas politikës.

Ai tutje thotë se jemi ngulfatur nga debatet e çdo nate në televizionet tona, të cilat, për ta plotësuar programin e tyre, secili televizion i ka opinionistët e vet, që herë-herë as vetë nuk dinë se çka flasin: Tha kështu, tha ashtu! I ka thënë, i kam thënë!

## KUR KA QENË LUFTA NË KOSOVË?

Me politikë sot për sot po merret gjithkush! Edhe fëmijët i dinë emrat e liderëve politikë... Paramendojeni një fëmijë amerikan të merret me politikë?! Se atyre nuk u intereson politika, më së miri po e ilustruj me



këtë shembull:

Ditë më parë në Redaksinë tonë erdhi një vajzë shqiptare, prindërit e së cilës ishin nga Prishtina, e cila ishte rritur e shkolluar në Amerikë. Hulumtonte në revistat tona shkrime që i nevojiteshin për temë diplome. Në një moment, i thash:

“Ajo temë ka qenë para lufte!”

“E, kur ka qenë lufta?!” ma ktheu.

Mbeta pa fjalë! Mbeta pa tekst! Përgatitë temën e diplomës dhe nuk di kur ka qenë lufta në Kosovë?! Tmeruese...

E, ne, shqiptarët, e kemi vulosë politikën në kokë dhe nuk na intereson gjë tjetër veç politikës. Skamjen sikur

e kemi hedhur pas krahëve dhe s’po merret kush me të, ani pse skamja na i ka futur të dy këmbët në një këpucë, madje në këpucë të shqyer, që depërton uji e balta kah të dojë vetë...

Por, një ditë, teksa prisja autobusin me numër 4, afër Gjimnazit “Sami Frashëri” në Prishtinë, disa nxënës, që edhe ata e prisnin të njëjtin autobus, debatonin për politikë...

Më kënaqi shpirtin kur njëri tha: Nuk më punon truri për politikë!

Thënë të drejtën, më shkoi buza në gaz dhe vetë me vete thash: Shyqyr, e ndjeva dikë të thotë se nuk i intereson politika! Paska edhe të tillë!

**Isa Ilazi**

# U BËFSHIN VEÇ PËR ILAÇE!



“Veç tema politike mos shkruani! Ka boll tema të tjera për çka e vlen të shkruhet”, thotë njëri në kafeterinë tek pimë kafe afër Redaksisë.

“Kurrë s’do kisha besuar se njerëzit bëhen kaq lakmitarë për kolltuk, për pushtet, veç për interesa të veta. Thjesht, personale... Qysh nuk kanë fytyrë, bre?! Eu, gjithë ato para që i vjedhin, Zoti ua ktheftë veç për ilaçe e avokat”, thotë ai, derisa del, duke mallkuar e sharë nga kafeteria. Kësaj radhe e dëgjova njeriun që e kishte raskapitur politika jonë. Nuk është ky i vetmi. Shumë janë të tillë, të cilët mendojnë kështu...

\*

Ka çaste, raste, në jetë, në përditshmëri kur edhe leximi, përsiatjet të lodhin, të mërzhitën. Njeriu nganjëherë e kërkon shpëtimin në shkujdesje, në mospërfillje... Mbase edhe pa dëshirë të vjen, të del, të ngacmon një moment, një fotografi e zverdhur, e kaluar, e ikur, por e dashur gjithëherë dhe gjithëherë e munguar, e dhimbshme... Dhe, ajo kohë e mbetur në

kujtime, tash të rri para sysh, as s’të ikë e as s’të largohet...

Natë e vonë maji. S’bën vapë siç bënte dikur. Moti paksa i çuditshëm: mëngjesi nis me diell, vazhdon ditën me vranësira, kah mbrëmja prapë pak diell, e përfundon me frymë dhe ftohtë natën...

Po kështu, një gjendje e tillë më trazon brendinë, shpirtin, lemza s’më lë të qetë... Kush më kujton? Kush më thërret?

Ç’më trazon ti moj lemezë, në këtë pikë nate?

Dëgjoj një këngë në telefon...

Dëgjoj një zë që m’i përkujton ditët e ikura, netët pa gjumë, dridhjet shpirtërore...

Bëj luftë midis së tashmes e të kaluarës në pa kthim.

Seç më vijnë në kujtesë vargjet e poetit:

Moj lemezë ç’më thua?

Kush më zë në gojë mua?

Pa dëgjo, të keqen s’dua

Të kujtoj se t’kam harrua

Lërmë o lemezë menjëherë

Kush e di kush më përmend...

**Gani Dili**

## KOSOVARJA

magazinë e pavarur  
për familje

[www.kosovarja.al](http://www.kosovarja.al)

**Pronar dhe botues:**

Gani DILI

**Redaktor përgjegjës:**

Isa ILAZI

**Menaxher:**

Driton DILI

**Redaksia:**

Safet Krivaça (reporter i lirë)

Nderim Neziri (redaktor)

Besiana Dili

Drenushë Haredinaj

Rilinda Krasniqi

Ardita Dili

**Dizajni:**

Labinot Bërbatovci

**Adresa e redaksisë:**

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75

Email: [info@kosovarja-ks.com](mailto:info@kosovarja-ks.com)

**Marketing:**

Tel: +383 44 143 448;

Email: [marketing@kosovarja-ks.com](mailto:marketing@kosovarja-ks.com)



# S'ka shi ku nuk ka dashuri!

*Pa dyshim rënia në dashuri mund të jetë një përvojë e bukur, e papërsëritshme. Por, të rinjtë kalojnë edhe nëpër periudha të ndryshme të jetës që quhet “lulja e rinisë”. Andaj, ç’thonë maturantët e Gjimnazit të Prishtinës për “lulen e rinisë”?*

## Si ndihet dashuria e vërtetë?

**Mirlinda:** - Për mua dashuria e vërtetë është si dashuria e Zef Serembes ndaj vashës arbëreshe. Kur ajo me familje shkon nga Kalabria për të jetuar në Brazil, ai merr rrugën e gjatë nëpër oqean që ta takoj atje.

**Erbliini:** - Pa dyshim, kujdesi për njëritjetrin, respekti, besimi dhe sinqeriteti, janë cilësi të cilat dashurinë e bëjnë të vërtetë.

**Verorja:** - Shenja e parë se, vërtet, je dashuruar, është mosangazhimi në shkollë! Humb interesimi për mësim. Nuk ke koncentrim as në shkollë e as në shtëpi. Je i tretur në mendime...

## Çfarë do bëje po të bije në dashuri në shok a shoqe të klasës?

**Verorja:** - Nuk di si të shprehem, por po ua them disa vargje:  
Unë pa ty s'rroj  
Vij e të kërkoj.  
Ti pa mua s'rron  
Vjen e më kërkon.

**Erbliini:** - Është vështirë po të gjenesh në një situatë të tillë. Sepse, e kam provuar. Me Veniten jam në lidhje që nga klasa X. Në fillim vetëm shoqëroheshim, shëtisnim bashkë, shkonim në kafe bashkë dhe hiç më shumë. Por, ajo me kohë e kuptoi se isha dashuruar në të dhe ma hapi rrugën, duke mu ofruar...

**Mirlinda:** - S'kam rënë në dashuri me shok të klasës, andaj nuk di si është ajo ndjenjë...

## Një aforizëm për dashurinë?

**Mirlinda:** - Me dashuri hajgare s'ka! Jam drenushë e plagosur, në shpirt e sakatosur!

**Erbliini:** - Dashuria është mjaltë nëse vajza të pranon. Është helm nëse të refuzon!

## Verorja:

Pyeta qiellin, pyeta zogjtë  
pyeta zemrën që mu dogj  
Pyeta lulen në saksi  
Pse zemra ime s'ka qetësi!

**Diturie Haxhaj**





# Takimi i radhës së Kryesis së Unionit me anëtarët e rrethit Bonn/ Rein-Sieg.

*Pjesmarrës nga Kryesia ishte Kryetari Nazmi Vija i shoqëruar nga nënkryetari, Gani Nuha, drejtori menaxhues, Bekim Bytyqi dhe sekretari, Nexhmedin Veliqi.*

Në këtë takim u diskutuan tema të ndryshme, si riorganizimi dhe restrukturimi i Unionit, ndryshimet organizative të shtrirjes së Unionit në Gjermani në degë. U ndëgjjuan mendime dhe iniciativa të cilat do të vazhdojnë në takimet e ardhshme me antarët në rajonet tjera të Gjermanis.

U shfletua dhe u diskutua po ashtu agjenda e aktivitete të planifikuara të Unionit për pjesën e dytë të vitit 2022.

Njëra nga temat ishte edhe fillimi i procesit të themelimit të një shoqërie aksionare të përbashkët investimesh nga antarët e Unionit.

Kjo do të lehtësonte rrugën e çasjes së pjesëmarrjes në projektet e ndryshme, si në Gjermani ashtu edhe në Kosovë.

Kjo u shtjellua me gjerë nga Skender Xhakaliu, ish Ambasador i Kosovës në Berlin, i ngarkuar nga Unioni në cilësinë e këshilltarit të Kryesis/Unionit për fushat e menaxhimit të projekteve dhe rrethit administrativ.

Takimi u përmbyll me zgjedhjen e Koordinatorit të ri për Bonn/Rhein-Sieg, Mentor Shehu. Zgjedhja e tij do jetë vazhdimësi e rrugës së këtij rrethi, të cilin me sukses deri tash e drejtoj si Koordinator, Fatbardh Blenishta.





# A na ka nemur kush apo e kemi nemur veten?

*Jetojmë në tokë të nemur. Tokë në të cilën është përgjakur sa e sa herë historia... E, si të mos jetë kjo tokë e nemur, pra?!*

Kosova është e mbushur me troje, lokalitete e vise që quhen të nemura. Nga kush vijnë këto legjenda, e që rrinë herë të fjetura e herë të zgjuara ndër njerëzit tanë?

Secili armik që ka ikur nga kjo tokë ka thënë nga diçka të tillë. Po ikim se është tokë e mallkuar! Edhe Bjeshkët

e Nemuna kanë shumë legjenda. Atje ku ka pasur shumë ngjarje të këndshme, por edhe të dhimbshme, kanë ditur të këndojnë për dashurinë dhe për bukuritë që i ka bërë natyra.

## A KA KOSOVA KROKODILË?

A keni dëgjuar për vendin "Kodra e Vajzës"?

A keni dëgjuar për "Kodrën e Sefasë"?

A keni dëgjuar për krokodilët më të vegjël në botë, që jetojnë në "Liqenin e Leqinatit", në maje të kodrës me po këtë emër, që ishte 30 për qind e Malit të Zi e 70 për qind e Kosovës?

Sivjet pranvera është herë e zyrtë,

herë me diell. Njerëzit që në mëngjes ankohen edhe për qiellin që nuk është në fuqinë e tyre! Fjala më e përhapur me të zgjuar është: "Na mbyti, bre, kjo kohë, s'mban mend kush këso pranvere të përgaztë!".

## PSE XHA TAHIRI KËNAQET KUR DËGJON RRENA?!

Është një plak në katundin tim. Ditën më shumë e kalon para shitoreve për të dëgjuar lajme e rrena. Dhe, kur e dëgjon njërin teksa ankohej, i thotë: "Po, çka po të duhet, bre, kohë më e mirë?! Me thënë që po punon diçka - jo!

Nëse thua që të ka mbetur pllugu në arë - jo!  
 E, çka dreqin po kërkon nxehtë?!"  
 "Jo, xha Tahir, por bajat këso kohe në pranverë! Tri herë në ditë po ndryshon koha! Na mbyti ndryshimi i motit!", ia kthen ai.  
 Dhe, sot është dita e tretë që po mban me diell. Por, edhe sot, me të gdhirë, disa ankohen se na kalli dielli!  
 Xha Tahiri ka dal edhe sot ku e ka vendin dhe i dëgjon të njëjtit si ankohen për diellin. "Na kalli! Nëse vazhdon kështu mos pyet për ne, ka me na kallë krejt!"  
 "Po ju, a ankoheshit për shi, ore?! Kërkonit diell e tash çka po ndodh me ju?! Zor me na ra në fije edhe Zoti neve, shqiptarëve! A po i përcillni debatet polemizuese ndërmjet VV-së e opozitës?!"

Një fjalë e urtë thotë se çdo gjë do të merret vesh herët a vonë, e ata po ia shpalosin njëri-tjetrit gjërat që i dinë vetëm ata! Do ta kuptoni prej tyre se kush është njëri e kush tjetri!  
 Kështu, pra, është edhe puna jonë, e shqiptarëve: Zgjohemi në mëngjes, kallim cigaren dhe ankohemi për shiun, duke kërkuar diell! E, të nesërmen, kur ngrohë dielli, ankohemi se dielli na kalli!  
 Nuk punojmë asgjë dhe nuk bëjmë dot asnjë punë as për ilaç, siç thuhet në popull. Askush nuk lexon, e të gjithë e dinë se çka po bëhet! Dinë se çka po ndodh edhe dy gratë e fqinjëve të mi, e që asnjëra s'e dëgjon tjetrën, por vetëm flasin e flasin...  
 Një ditë isha në ballkon e i dëgjoja...  
 Njëra fol e tjetra fol... Asnjëra s'e dëgjonte tjetrën se ç'thoshte...

## EDHE PLAKAT MERREN ME POLITIKË!

Andaj, ky vend kishte qenë i mallkuar e ashtu ka mbetur... Askush nuk bën lum këtu! Të mallkuar jemi! E, kush na bëri të tillë, kush na bëri të jemi të paretshëm?!  
 Vetë i bëjmë të gjitha e, pastaj, e hedhim gurin prej dore, duke thënë se jetojmë në tokë të nemur.  
 Pra, dikush na ka mallkuar apo e kemi mallkuar veten...  
 Përndryshe, pse e tërë kjo tollovi në Kosovën tonë të dashur?  
 Sepse, çdokush merret me politikë!  
 Edhe plakat që nuk dinë shkrim-lexim, e edhe çobanët...

**Sokol Murturi**



[www.sheshoes-ks.com](http://www.sheshoes-ks.com)

 /sheshoesks1



# Si jetohet sot në Grashticë?

*Gallapi pat një nga masakrat më të tmerrshme që njeh historia e njëzimit. Për 500 të vrarë, siç thuhet në Grashticë, nuk është ngritur asnjë aktakuzë në Hagë e askund gjetiu! Andaj, ajo që brengosë më së shumti është se askush nuk është marrë juridikisht me masakrën e Gallapit. Sidoqoftë, edhe pse kanë kaluar 23 vjet, edhe sot në Gallup jetohet me plagët e vitit 1999, por jeta vazhdon me hallet e përditshme...*

Të martën, më 31 maj, kompleksi memorial i varrezave në Makovc pushonte i qetë nën rrezet e diellit pranveror, përderisa disa familjarë kujdeseshin për lulet e kurorat e vendosura mbi varre.

Një nënë, me shami lidhur në fyt, me zë të ulët, flet me të birin, duke i thënë “djali i nënës”.

Rreth 500 shqiptarë ishin vrarë prej datës 18 deri më 21 prill 1999, në ngushticën malore në Grashticë, afër Prishtinës, duke u vrarë e prerë nga dora serbe e formacionit paramilitar të Zhelko Razhnjatović-Arkani, një ushtri famëkeqe, që e kishte legalizuar Milosheviqi për krime ndaj shqiptarëve në Kosovë.

## SI I NXORËN NGA AUTOBUSI BABË E BIR NË LLAPNASELLË?

Bajram Krasniqi rikujton babanë Hajrizin dhe vëllanë Bashkimin, të vrarë më 12 maj 1999, nga serbët në Llapnasellë të Prishtinës, e ku ishin nxjerr nga autobusi babë e bir, me t’u kthyer nga Gjilani, ku kishin qëndruar që nga data 18 prill, pasi kishin mundur të largoheshin nga shtëpitë, në Grashticë, teksa kishin ikur forcat e mëdha paramilitare nga ky vend. “Kemi qenë 21 anëtarë të familjes në autobus, duke u kthyer nga Gjilani”, thotë ai dhe tregon se si i nxorën nga autobusi babë e bir.

“Patëm qëndruar në Gjilan 26 ditë. Prej atje na urdhëruan serbët të ktheheshim në Prishtinë. U nisëm me autobusin që udhëtonte në këtë linjë dhe kur kemi ardhur në Llapnasellë, autobusi është ndalur në postbllokun paramilitar që ndodhej aty. Kanë hyrë disa paramilitarë në autobus dhe na i kanë kërkuar letërnjoftimet. Babait tim ia kishin marrë letërnjoftimin qysh kur ishte larguar nga Prishtina dhe ai më nuk kishte kurrfarë dokumenti të identifikimit. I thotë se m’i keni marrë ju dokumentet, prandaj edhe nuk i kam. Vëllai im, Bashkimi, e kishte letërnjoftimin dhe ngrihet në këmbë e u thotë se është babai im dhe se unë e marr

përsipër këtë përgjegjësi.  
Por, paramilitarët i thonë babait dhe Bashkimit që të dy të zbresin nga autobusi, ku edhe i kanë ekzekutuar”, thotë Bajrami.

## PRITAT SERBE TE “KALAJA E VOGËL” NË GRASHTICË

Duke treguar zhvillimet e ngjarjeve, Bajram Krasniqi, tregon se si forcat serbe ishin grumbulluar përgjatë luginës malore mbi Prishtinë, duke u pozicionuar për të masakruar shqiptarë.

Ata i pritnin në pusi të zhvendosurit, që kryesisht ndodheshin në Mramor, Busi e Marec dhe ktheheshin për në Prishtinë, pas intervenimit policor që u bë në ato fshatra...

“Në fshatrat që i përmendëm, ka pasur shumë civilë dhe të zhvendosur. Forcat serbe kanë hyrë atje me tanke dhe banorët janë detyruar të rreshtohen në kolonë dhe të drejtohen për në Prishtinë.

Natën e kanë kaluar mbi Grashticë, në male. Më 18 prill janë rreshtuar vetë dhe ia mësyjnë Prishtinës, pa e ditur se forcat serbe të Arkanit janë duke i pritur.

Posa ka arritur kolona e të zhvendosurve në Lagjen Ugriaj të Grashticës, kanë rënë në pritë nga paramilitarët e droguar të Arkanit. Ka filluar masakrimi i meshkujve shqiptarë të kolonës. Të parët që janë zgjedhur për t’u masakruar e vrarë kanë qenë të rinjtë. Janë tmerruar njerëzit kur kanë pa se çka bënin mbi trupat e tyre...

Mënyra e masakrimit ishte trishtuese. Edhe flokët ua kanë nxjerrë nga koka! Edhe gishtat ua kanë thyer! I kanë lënë kufomat rend nëpër lagje. Gratë dhe fëmijët, që kanë kaluar nëpër kolonë, janë tmerruar me pamjet që kanë parë, janë traumatizuar...



Në disa shtëpi të Grashticës i kanë futur disa gra dhe, pas tërheqjes, janë gjetur tuba flokësh, që do të thotë se edhe gratë kanë kaluar nëpër brutalitetin e dhunës dhe barbarisë paramilitare të Arkanit”.

## SI I NDANIN FEMRAT NGA KOLONA?

Përgjatë kolonës së shqiptarëve, që po ktheheshin nga Gallapi, forcat serbe i kishin ndalur të rinjtë shqiptarë dhe i kishin grumbulluar në stallën afër rrugës. I kanë mbajtur me duar mbi kokë për shumë orë dhe, pasi ka kaluar kolona, i kanë nxjerrë në rrugë dhe i kanë vrarë nga afërsia.

Të gjithë ata i kanë varrosur në varrezat e vjetra të Makocit dhe në lëndinat e vogla nën kaçuba malore. Janë gjetur kufomat e tyre gjatë verës e deri në vjeshtë të vitit 1999.

Gjëra të tmerrshme janë bërë nga paramilitarët serbë edhe ndaj femrave të kolonës, por ajo që ka mbetur e pashpjegueshme është se krimi më i tmerrshëm i Gallapit nuk është bërë kurrë pjesë e aktakuzës së asnjërit prej lidheshit serb dhe ndaj këtij krimi sot e atë ditë kurrë askush nuk ka ngritur aktakuzë ndaj dikujt në Serbi!

Banori i Grashticës, që nuk preferon t’i përmendet emri shkaku i ndjeshmërisë, tregon se atë ditë, më 18 prill 1999, forcat serbe i kanë vënë dy femra në ballë të kolonës.

“Në një moment njëren nga femrat e kanë vrarë. Ishte gati lakuriq. Një plak ndahet nga kolona dhe i hedhë sipëri pallton e vet.

Burrat që i ndanin nga kolona me shqelma i rrëzonin në përroskën e lumit. Pastaj, i vrisnin me rafal automatiku... Nga ai tmerr kishte shpëtuar një person, edhe pse i kishte 18 plumba në trup. Quhej Agim”, tregon ai. Vrasje ka pasur edhe në shtëpinë e Nebihut, në Makoc. Janë gjetur shenjat e plumbave që e kanë goditur

murin e shtëpisë së vjetër, që do të thotë se i kanë pushkatuar me rafal. Një rast tjetër i tmerrshëm ka ndodhur kur një nëne kanë dashur t’ia marrin djalin e vogël nga dora dhe pasi ajo nuk e ka lëshuar, serbët e Arkanit e kanë qëlluar me thikë në shpatulla të këmbës nëntë herë. Ajo e ka kuptuar se është goditur me thikë vetëm kur ka arritur në Prishtinë, pasi e ka hetuar se çizmet i janë mbushur gjak.

## SI JETOHET SOT NË GRASHTICË?

Grashtica është vendbanim me relief kodrinoro-malor, fshat i komunës së Prishtinës, që së fundi i ka kthyer sytë kah turizmi. Shaban Berisha, mërgimtar nga Zvicra, ka investuar në vendin e tij të lindjes me ndërtimin e 15 vilave.

Grashtica njihet edhe për nga vlerat arkeologjike e artefaktet mijëra vjeçare të gjetura në zona të ndryshme të saj. Bajram Krasniqi, banor i Grashticës, thotë se tash e 23 vjet pas krimit serb në këtë fshat, jeta në këto anë vazhdon dhe fare pak njerëz e kanë braktisur fshatin. Që moti janë rindërtuar shtëpitë e djegurat dhe janë ndërtuar shumë shtëpi të reja.

Por, ajo që brengosë është se papunësia në këtë fshat, si dhe në fshatrat e tjera përreth, është shumë e madhe. Andaj, një pjesë e popullatës së kësaj ane janë detyruar të shpërngulen në Prishtinë, shkaku i kushteve më të mira për jetesë...

Por, edhe pse ndodhet vetëm 10 kilometra larg kryeqytetit, banorët thonë se u mungon transporti. Oraret e rralla të mjeteve që i bartin udhëtarët në këtë anë, e vështirësojnë jetën e banorëve të kësaj ane edhe më shumë.

Sidoqoftë, krahas dhembjes, jeta në këtë fshat vazhdon me hallet e përditshme për ekzistencë...

**Safet Krivaça**



# Na shkoi jeta t'u u marrë me politikë!



*Më është bërë bajat të flas a të shkruaj për politikë. Kisha dashur në këto çaste të jem bari e të ruaj bagëtinë. T'i kisha nja 100 krerë dele dhe t'i kullosja në kodrën time...*

Por, dëshirën ma prish uzurpimi i kodrës, sepse ish-kryetari i komunës, njërit nga Maqedonia, ia ka dhënë truallin për biznes të dhive mu te vendi i bukur, "Pishat".

E, më vonë, ai e uzurpoi tërë kodrën me sa e sa hektarë...

Nuk më ka mbetur as të kem dëshira më, them me vete. Nuk mundet njeriu me këtë pushtet as të meditojë, sepse çfarëdo vendi të bukur natyror që ka ekzistuar, ai është uzurpuar dhe shitur nga shteti dhe nuk ka mbetur vend as për meditim.

"Më falni", u them deleve të paragjykuara, "kullotni ku të mundni se kodrën tonë e kanë uzurpuar njerëzit e shtetit!".

Dhe, sot më nuk dua të merrem me askënd, them me vete, por as delet nuk kam ku t'i kullos. Më së miri të isha haxhi dhe t'i kullosja nëpër arat e mëhallës, duke u bërë dëm të tjerëve,

por me bindjen se sa ta kem teleqen e bardhë në kokë nuk do më rrahin.

## **KAPE HAJNIN!**

Një shitës, nuk po ia përmendi emrin se në fshatin tim e njohin të gjithë, e thyen shitoren e vet para nja 40 vitesh dhe rastin e paraqet në polici. Policët me vete kishin marr qenin nuhatës dhe e urdhërojnë: "Kape hajnin!". Dhe, qeni e kapë të zotin e shitores për këmbë. Njëri prej policëve i thotë: "Ti je hajni, a?!". Ai e pranon, por polici tjetër e lut të mos tregojë se kanë qenë bashkë se do e burgosin edhe atë...

**S. Murturi**

# Cilat politike kosovare e ndjekin modën?

*Janë politike, por kjo nuk do të thotë se edhe stili i tyre i veshjes duhet të jetë aq formal e serioz sa puna që bëjnë. Paraqesim femrat e zonja të politikës, që janë aq të mira në stil sa edhe në mendime e logjikë politike...*

## VLORA ÇITAKU

E re në moshë, por me role kyçe në politikë. Deri më tani ka pasur disa poste të rëndësishme. Agjenda e saj, pa dyshim, ka qenë e vazhdon të jetë e ngjeshur dhe me shumë takime, në të cilat ajo kujdeset që, ndër të tjerash, të duket ashtu siç duhet, me shije e klas. Nganjëherë thyen shablonet klishe të veshjes formale...



## BLERTA DELIU-KODRA

Deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës në disa mandate deri më tash, Blerta Deliu-Kodra, jo vetëm që është e zonja në punën që bën, por rëndësi të veçantë i kushton edhe kodit të veshjes bukur. Është njëra nga ato që përherë bën kujdes në zgjedhjen e gardërobës.

## MIMOZA KUSARI-LILA


Mimoza Kusari-Lila prej vitesh është aktive në jetën publike. Është ekonomiste me profesion dhe duket se kalkulon me saktësi çdo gjë: deklaratat, veprimet, madje edhe stilin. Kusari-Lila e ka gjetur me kohë lukun e saj që i përshtatet me linjat dhe pozitën që ka në shoqëri. Aksesorët nuk janë pjesë e stilit të ish-kryetares së Gjaskovës, Mimoza Kusari-Lila.



## DONIKA KADAJ-BUJUPI

Kaçurrelja e politikës, ish-deputetja Donika Kada-Bujupi, ka arritur të bëjë balancë të mirë mes asaj që përfaqëson dhe veshjes që bartë. Zonja në fjalë, në një rast, ka thënë: "Është interesant se si njerëzit më shumë i kushtojnë vëmendje asaj që veshim sesa asaj që themi".





# Pse në katundin tim gjithçka bën vakti?

*Në Gadime të Lipjanit dikur kanë qenë të gjithë të mençur! Qind për qind më të mençur se sot disa politikanë tanë. Ndërtonin pishina e basene dhe pas larjes pushonin nën hijet e shelgjeve! E, nëse besoni e keni gabim, sepse pas larjes në pishinë askush nuk pushon nën hije, por rrezitet në diell...*

## TË PADIJSHMIT NË PUSHTET

Në vitin 1981 ishte njëfarë mode politike që t'i detyronin në fshat ta ruanin fshatin nga irredentizmi. Në fshatin tim, pra në Gadime të Lipjanit, dilnin do pleq dhe i merrnin me vete edhe disa të rinj.

Nata kalonte tërësisht me batuta dhe humor, por ishin do komunistë pak më të devotshëm që ia mbanin vetes të ditur, e që nuk dinin gjë. Një natë vere po flisnin për pasuritë natyrore të fshatit dhe për lumin që rridhte nga malet. Lumi gjatë rrjedhjes kalonte fusha e male, zabele e lugina dhe fakti që kishte bukuri natyrore, ne i ngacmonim komunistët, duke u thënë:

“O burra, a po e dini çfarë bukurie natyrore kemi ne?! Po ta kishim republikën tonë do të bënim edhe pishina e basene për larje e pushim!”

Kryekomunisti e pohonte me kokë që

demek keni të drejtë, kurse ne, pastaj, i thoshim se kemi shumë hije dhe lahet sa lahet njeriu në pishinë e ulet nën hije... Ai sërisht me kokë e pohonte në shenjë të asaj se e keni mirë, por kurrë nuk i binte në mend se pas larjes duhet me u rrezitur e jo të hyhet nën hije.

Kështu, disi, janë edhe disa politikanë tanë, meqë shpesh i ngatërrojnë gjërat...

## XHEMATI I KEQ

Në vitet 80 në fshatin tim punonte berber një i moshuar, për të mos thënë plak. Ishte nga një fshat jo larg fshatit tim. Një ditë para faljes së xhumasë ishte ulur në një dru shelgu dhe shënonte diç në fletoren e tij...

“O berber, çka po shkruan në atë fletore?”

“Të tregoj më vonë, veç mos më pengo tash!”, ma ktheu.

Kur xhemati hyri në xhami, ai më tha:

“Në fletore i kam emrat e atyre që shkuan

në xhami”.

Në fletoren e tij figuronin edhe emrat e disave me të cilët ai pothuajse tërë ditën luante shah në lokalin e tij...

“Eh, pra, çfarë xhemati ka në xhami!”, thamë njëzëri.

## SA NË LIPJAN SA NË SHKUP!

Xha Hamitin e kisha fqinj. Pothuajse çdo ditë shkonte në Lipjan, punë e pa punë. Meqë fqinji tjetër punonte në komunë, ai e dinte kohën kur ai udhëtonte me veturë dhe e priste në rrugë. Një ditë ia bën me dorë ta ndalte veturën.

“Xha Hamit, sot jam tu shku në Shkup”, i thotë ai, me shpresë se ai do t'i thotë jo, s'kam punë atje...

“Në Shkup, a?! Po unë bash në Shkup kam punë!”, i thotë teksa hynte në veturë.

S. Krivaça



# tourist CAMPING



Adresa: Shtoj, Ulqin    [www.touristcamping.me](http://www.touristcamping.me)    Tel: +38269336233    [/touristcamping\\_giovannisbeach](https://www.instagram.com/touristcamping_giovannisbeach)



## Giovanni's Beach COPACABANA



Adresa: Shtoj, Ulqin    [www.touristcamping.me](http://www.touristcamping.me)    Tel: +38269825858    [/giovannis\\_beach\\_montenegro](https://www.instagram.com/giovannis_beach_montenegro)

# Çka i tha Klintonit gjyshja e Kaltrina Selimit?



Në vitin 1999, më 6 maj, presidenti amerikan, Bill Klinton, viziton qendrën e të deportuarve shqiptarë nga forcat ushtarake dhe policore serbe në Kosovë, e që kishin gjetur strehim në Ingelheim të Gjermanisë. Në qendrën e strehimit të këtij qyteti, Klinton, ndër të tjerash, tha: “Do të doja të shpreh respektin tim për familjet që janë këtu, nga Kosova... Për ata që na kanë treguar rrëfimet e jetëve të tyre – zemrat e thyera, makthet, mizoritë dhe pasigurinë, për ata që janë të rinj, për ata që janë të moshuar, ata që janë të moshës së mesme.

Ju dëgjova me shumë kujdes. Bota do të dëgjojë historitë e juaja. Është me rëndësi që çdo person që do lirinë në botë të dijë rrëfimin për Kosovën. Është me rëndësi që njerëzit të mos harrojnë se ajo që quhet spastrim etnik nuk është ide abstrakte”, shtoi ai. Në këtë vizitë është bërë edhe një foto emblematike, që lë mbresë të pashlyeshme. Në foto është një nënë e moshuar shqiptare, tashmë e ndjerë, tek përqafton presidentin amerikan. Përhapja e kësaj fotografie ka befasuar për të mirë familjarët – ata që ishin e

nuk ishin pranë saj më 1999, pasi asnjëri nuk e kishte të fiksuar në fotografi një moment të tillë të veçantë. Ajo është Hasibe Selimi, nëna e profesorit të regjisë së teatrit në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës, Agim Selimi, si dhe gjyshja e këngëtares së mirënjohur, Kaltrina Selimi. Klintoni, sipas familjarëve që ishin pranë saj, e kishte pyetur plakën Hasibe se çfarë dëshire ka. Ajo i kishte thënë: “T’i largosh forcat serbe, të na kthesh në shtëpi dhe ta shpëtosh Ibrahim Rugovën nga Sllobodan Millosheviqi”.

Modele: Valentina Rexhaj

# BOOM

Këngëtaret tona  
që tatuazhin  
e konsiderojnë  
haram!

A iu kthye  
këngës  
Lumturije  
Axhami?

**Valentina Rexhaj**  
*- dikur me shpirt të lënduar,  
sot një nga gratë më të fuqishme*

# Valentina Rexhaj

## - dikur me shpirt të lënduar, sot një nga gratë më të fuqishme

Valentina Rexhaj është femra që ka bërë për vete një “armatë” të tërë njerëzish, të cilët i besojnë fuqishëm ato që thotë, ato që beson dhe transmeton, e që janë një ideologji që ka në krye vendosjen e qëllimeve dhe besimin në to, ngritjen e moralit dhe vetëbesimit, punën me veten për ta dashur veten.

Valentia Rexhaj është medituese dhe motivuese e jashtëzakonshme, një shkrimtare e afirmuar dhe një grua që ja ka dalë suksesshëm të jetë një nga personalitetet e njohura shqiptare.

Për të rejat e saj lexoni ekskluzivisht në “Kosovare”...



**Valentina Rexhaj, tashmë emër i konfirmuar si motivuese, autore librash, femër e fortë. A ke menduar se një ditë do të bëhesh kjo që je sot?**

- Fillimisht e nisa që t'u ofroj ndihmë njerëzve, qoftë edhe, thjesht, një personi. Pastaj, vendosa qëllime më të mëdha, që më bën personin që jam tani.

**Nëse kthehesh në kohë, si e kujton Valentinën e dikurshme?**

- Pa vetëbesim, pa dashurinë ndaj vetes. Më kishin bindur se nuk meritoj më shumë. Isha një vajzë me një fëmijë të lënduar brenda.

**Si u bë Valentina e dikurshme kjo e sotshmja dhe cila është rruga që përshkove?**

- Fillimi i meditimit dhe leximit të shumë librave, shikimit të mijëra videove motivuese, mbajtja e shumë seminareve dhe kurseve, kanë bërë që unë të jem kjo që jam sot.

**Sot a je e plotësuar?**

- Varet se çka quan dhe konsideron dikush “plotësim”. Natyrisht, me perceptimin tim jetoj

ashtu siç unë dua dhe i jetoj ëndrrat e mija.

**Çka konsideron formulë suksesi?**

- Vetëbesimin dhe këmbënguljen. Sigurisht, me vetëbesimin duhet të punojmë gjithnjë, sepse kur ke besim në vetvete, atëherë gjërat arrihen më lehtë.

**Si arrite t'i bësh për vete gjithë këtë “armatë njerëzish”?**

- Duke qenë autentike dhe duke dhënë gjithë ato që mua më kanë ndihmuar ta ndryshoj realitetin tim...

**A ke qenë plotësisht e bindur në vete me faktin se ky sukses që gëzon sot do të jetë realisht suksesi yt?**

- Në fakt, ky është vetëm fillimi i asaj se çfarë unë besoj dhe meritoj. Besimi është gjithçka. Së pari e besojmë pa e parë dhe pastaj e shohim, sepse e kemi krijuar.

**Keni botuar katër libra. Cili më i dashur, më i këshillueshëm për njerëzit?**

- Është njëjtë sikur ta pyesësh dikë se cilin fëmijë e ka më të

dashur. Për mua të gjitha krijimet e mija e kanë vlerën e vet. Por, nëse pyetem se cilin libër do ta kisha propozuar, atëherë është “Një fillim i ri”.

**Jeni medituese, hipnotizuese, motivuese, autore librash. Si gërshetohen të gjitha këto mes vete?**

- Janë të gjitha të lidhura, e gjitha është një filozofi-psikologji. Meditimi është ai që na afron afër asaj se kush jemi në të vërtetë.

**Jeni ndër të parat shqiptare që praktikuat dhe i bëtë të tjerët ta praktikojnë meditim...**

- Në fillim e kam ditur që njerëzit do të jenë skeptikë, por ngaqë ne lindim meditues dhe kjo është natyra jonë, pra është njerëzore dhe jo diçka që vjen veçanërisht nga India apo vende të tjera, e kam ditur se me kalimin e kohës do të pranohet dhe do të ketë njerëz që do të duan të afrohen me veten dhe ta shijojnë jetën në të tashmen, në vendin e vetëm ku ajo është.

**Mbani kurse dhe seminare gjithandej dhe thuhet se shumë njerëz e kanë ndryshuar jetën nga leksionet tua. Si arrihet kjo?**

- Po, kam mbajtur kurse për financa dhe transformim dhe kam hapur akademinë, e cila do të fillojë punën së shpejti.

**Në shtator vjen një festival i madh. Për çka bëhet fjalë më konkretisht?**

- Festivali i parë shqiptar i këtij lloji. Kam mbledhur bashkë me bashkëpunëtorin tim, Klisman Metin, njëmbëdhjetë mentorë të ndryshëm, së bashku me këngëtarët Sabri Fejzullahun dhe Alban Skenderajn, si dhe një ansambël, me ç'rast do ta mbajmë një festival që do të mbahet në mend si më i madhi i mbajtur ndonjëherë në Kosovë.



**Si të lindi kjo ide?**

- Kjo ide më ka ardhur kur kam qenë në energji të lartë, apo, siç e quaj unë, në vibrim të lartë. E, njerëzit kur janë kështu janë të gatshëm të zgjohen... Ka qenë ëndrra ime që t'i mbledh mentorët më të mirë në një vend dhe së bashku të bëjmë diçka të mrekullueshme për popullin tonë.

**Me gjithë këtë angazhim ku ti investon shpirtin, si po shkon jeta private?**

- Shumë mirë, sepse kam një staf që më përkrahë, andaj jam pa masë falënderuese se me sa dashuri më përkrahin mua njerëzit, në përgjithësi.

Fëmijët, natyrisht, që marrin dozën e dashurisë nga unë dhe s'do t'u mungoj asnjëherë as koha e as dashuria e pastër. Bashkëshorti është shok, burrë dhe një njeri i mrekullueshëm, që e ka pranuar rrugëtimin tim dhe që tani ecim bashkë në këtë rrugë të bukur.

**Si po e mbyllim këtë bisedë?**

- Mos ndaloni të punoni për vete dhe të bëheni versioni më i mirë i vetes! Bota ka nevojë për njerëz të cilët janë shembuj, njerëz që i jetojnë ëndrrat e tyre, që janë autentikë dhe që e duan veten.

Duani veten dhe jetën!

**Nderim Neziri**

Nuk u pëlqejnë apo...

# Këngëtares tona që tatuazhin e konsiderojnë haram!

*Yjet që bëjnë tatuazhe menjëherë janë në lajme, pasi gazetarët i pikasin dhe më pas duan t'i deshifrojnë kuptimet e tatuazheve të tyre. Por, cilët janë të njohurit tanë që nuk pëlqejnë të kenë një simbol të përjetshëm në trupin e tyre?*



## LEONORA JAKUPI

Këngëtares Leonora Jakupi nuk i pëlqejnë tatuazhet dhe asnjëherë nuk ka menduar të ketë ndonjë, pasi më shumë i pëlqen vetja, natyrale.

Leonora thotë se nuk ka asnjë tatuazh, pasi për shijen e saj nuk duken mirë dhe janë të rrezikshëm për shëndetin.

“Arsye tjetër pse nuk i dua tatuazhet është se jam besimtare dhe feja jonë i ndalon, kështu që ka shumë arsye pse asnjëherë nuk më ka shkuar mendja të bëj diçka të tillë dhe jam kundër, pasi më pëlqen natyralja, ashtu si më ka falur Zoti”, tha Leonora.



## ALMA BEKTASHI

Edhe Alma Bektashi nuk ka asnjë tatuazh, por i pëlqen kur ia sheh dikujt tjetër, sidomos Jonida Maliqit, e cila i ka dy tatuazhe të vogla: në këmbë dhe në gisht. Alma thotë se ka dëgjuar se vendosja e tatuazheve nuk lejohet me fe, ndonëse mendon se tatuazhi është art në vete.

“Nuk i pëlqej tatuazhet e tepërta, në gjithë trupin ose në gjithë krahun, sepse për një femër mjafton një detaj shumë i vogël”, shprehet ajo.

# A iu kthye këngës Lumturije Axhami?

Ditë më parë Salla e Pallatit të Kulturës në Kërçovë ishte nikoqir për të pranuar adhuruesit e këngës së bukur shqipe, këngë të cilat, me një mjeshtri dhe profesionalizëm të vërtetë, në 45-vjetorin e saj në skenë, i prezantoi këngëtarja e mirënjohur Lumturije Axhami-Sejdini.

Lumturije Axhami u lind në Han të Elezit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse të mesmen në Shkup. Talenti i saj për muzikë u vërejt shumë herët, qëkur ishte në bankat e shkollës fillore.

Që në moshën tetëvjeçare, filloi të këndonte në SHKA "Emin Duraku" të Shkupit dhe në "Sharri" të Hanit të Elezit. Shquhej për zë të ëmbël dhe për sharm skenik. Regjistrimet e saj të para u bënë në Radio-Prishtinë dhe në Radio-Shkup.

Në vitin 1981 mori pjesë në Festivalin e këngëve popullore në Itali, në kuadër të shoqërisë "Emin Duraku", me ç'rast u shpërblye me çmimin "Debutuesja më e suksesshme".

Shtrohet pyetja: Me organizimin e koncertit në Kërçovë, a iu kthye sërish këngës Lumturije Axhami?



E dua, më do, por...

# A do të martohem me djalin që bëra seks?

*Jam njohur me familjen e tij dhe u kam treguar gjithçka vëllezërve të mi. Kam ndjenja, por nuk doja të bëja seks me të pa u martuar. Por, ai as që më kuptoi. U zura ngushtë. I tregova time motër për çfarë ndodhi...*



Ka dy vjet që jam në lidhje dashurie me Drenin, me të cilin u njoha në një ndejë të dajallarët e mi. Atë natë mar-tohej im dajë dhe me gazim të madh e kam pritur atë ditë...

E, madhështia e asaj dasme për mua ishte edhe më e madhe kur në tavolinën ku isha ulur unë, përballë meje, ishte djaloshi me emrin Dren, përafërsisht moshatar imi, i cili tërë kohën nuk m'i largonte sytë.

Shikimi i tij ishte aq sa ledhatues po aq edhe thumbues, meqë herë-herë e zija duke më shikuar vjedhurazi.

## SI NISI "LOJA" JONË?

Pas një kohe të gjatë më ftoi të vallëzonim, sepse çifte të ndryshëm vallëzonin që nga fillimi i ahengut, meqë edhe muzika që bëhej në dasmë ishte më shumë për vallëzim.

U hamenda, të them të drejtën, por, më në fund, vendosa të ngrihem. Më përthekoi për beli dhe filluam të vallëzonim. Herë-herë më afrohej aq afër

sa edhe i dëgjohej frymëmarrja.

Pas pak faqja e tij u përputh me timen dhe më pyeti si quhem. Ndërkohë, më tregoi se quhej Dren dhe se ishte nga Prishtina. Më tha se ishte shok i dajës tim, shok i studimeve.

Dhe, në kohën kur pushoi muzika unë shfrytëzova rastin që të ndahem nga ai dhe u ula në karrigen time. Edhe ai u ul po në të njëjtin vend ku ishte, pra afër meje...

Dhe, teksa darkonim, një sms i erdhi në telefonin e tij. U skuq paksa dhe më shikoi vëngër...

Pas një kohe nga kamerieri mori lapsin dhe shënoi diç në një letër. E, kur nisi muzika përsëri më ftoi të vallëzonim. E kundërshtova, por ai ishte këmbëngulës. U desh të ngrihem. E, qëllimi i tij nuk kishte qenë këtë herë vallëzimi, por të ma jepte letrën në të cilën shihej se shkruante diçka...

E mora, e bëra truq dhe e futa në gji, meqë fustani im nuk kishte asnjë xhep.

Me padurim prisja të shkoja në toalet dhe të shihja se ç'shkruante në letër. Kur veç shkova, në të ishte një numër telefoni.

Të nesërmen jo, e as pasnesër, por ditën e tretë nuk u durova më dhe ia bëra një zile. Shpejt e shpejt më thirri. Ishte zëri i tij...

Kështu, edhe filluan sms-të tanë, pastaj takimet, puthjet...

## PSE I FRIKËSOHESHA SEKSIT ME TË?

Por, edhe pse koha ecte, nuk dëshiroja të bëja seks me të para se të fejohehim. Mirëpo, pas pesë muajsh në lidhje, ai shfrytëzoi dobësinë time në një takim jashtë qytetit dhe bëmë seks. Për mua ai seks ishte më shumë dhunim, pa pëlqimin tim.

Sepse, dëshira ime ishte që, së pari, të fejohehim, e tek pastaj të kalonim edhe në kënaqësitë që ofron seksi.

E, a do të fejohehi, do e tregojë koha?

**R. Tymi**



**MARITIM**  
RESORT MARINA BAY



**Mandarine Restaurant by Marina Bay**  
+35533410000  
+355696041000

**Lime Lounge by Marina Bay**  
+355696041001  
info@marinabay.al  
www.marinabay.al

**Adresa:** Vlorë, Shqipëri

# Kosova, maden i vajzave të bukura

*Me ardhjen e shatcave në Kosovë, gjallëria në rrugët e Prishtinës, por edhe të qyteteve të tjera të Kosovës shtohet aq shumë sa njeriu s'ka kah kalon prej veturave, shumica e të cilave janë luksoze.*

Valushi, djalë rreth të 30-ave, ka tri javë që është në Kosovë, konkretisht në Gjilan. Ai jeton ë Zvicër. Atje ku jeton ai, në Basel, thotë se nuk sheh njerëz në rrugë, veç atyre që vrapojnë për në punë.

E këtu, në Gjilan, por edhe në Prishtinë, rrugët janë të mbushura me njerëz, qoftë gjatë ditës, qoftë gjatë mbrëmjes, por edhe në orët e vona të natës.

Ai thotë se i kënaqet zemra kur sheh kudo me bollëk vajza të reja, të bukura, engjëllushe...

## SHQIPTARËT - ME PLAKA GJERMANE PËR DORE!

"Atje ku jetoj unë, në Basel të Zvicrës, të merr malli të shohësh vajza të reja, të bukura. Kudo sheh plaka, me

rrudha të mëdha në fytyrë e qafë, me ndonjë djalë për dore. Ata janë, kryesisht, të rinj nga vende të ndryshme të botës, kryesisht shqiptarë, kurdë, sirianë e të tjerë, që kanë ardhur të gjejnë strehim në Zvicër. Dhe, për të ardhur deri të leje qëndrimi, lidhen me plaka sa për të pasur ku të strehohen.

Kjo është njësoj si vajzat tona që lidhen me huajt që ndodhen në Kosovë. Por, në një gjë jam i sigurt: vajzat shqiptare nuk rrëzohen lehtë siç rrëzohen të huajat..

## S'KA VAJZA MË TË BUKURA SE NË KOSOVË!

"Në Kosovë, në cilindo qytetet të saj, e edhe në katunde kudo ka vajza të bukura, të cilat nuk t'i zë syri as në Zvicër, as në Gjermani ku kam qenë disa herë,

e as në Belgjikë.

Kudo nëpër lokale e klube të ndryshme vezullojnë femrat me bukurinë e tyre, atmosferë që nuk e gjejmë as në vendet më të zhvilluara të Evropës. "Vërtet, këtu, në Kosovë, asgjë nuk mungon. Por, një gjë duhet theksuar, femra të bukura si në Kosovë askund s'ka. Kosova është maden i femrave të bukura dhe populli i Kosovës duhet të krenohet me këtë gjë", shpreh bindjen e tij Valush Hajdini, nga Gjilani. Por, nuk është vetëm Valushi që ka bindje të mirë për vajzat e Kosovës. Njëjtë mendon edhe Daorti dhe Mentori, e që të dy jetojnë në Dyseldorf të Gjermanisë, që në Kosovë janë qe një javë, ku do të qëndrojnë edhe dy javë të tjera. Të dy janë me prejardhje nga Ferizaj.

L. Ajeti



# Kthema unazën!

*Lotët nuk mundet kush t'mi ndalë, sepse anija e përmbysur e fatit tim u thye shumë copësh. Tash jam një e mjerë dhe e katandisur, sepse humba çdo gjë në jetën time dhe ky mjerim do më shoqëroj deri në varr.*

U njohëm në ditëlindjen e vajzës së tezës. Në fillim më bëri përshtypje me se si ishte veshur, e më pas më pëlqeu forma e mrekullueshme se si komunikonte me të tjerët me aq sensualitet. Nuk fliste tepër dhe atë që thoshte e bënte me bindje të plotë. Ishte tip jo shumë elegant, por diçka kishte të fshehtë, diçka instinktive që më ngacmonte mua. Me fjalë të tjera, çdo gjë e tij më pëlqente. Por, përkundër kësaj, nuk lëshohesha shumë me të. Dhe, kur e lëshuan muzikën, më zgjati dorën që të ngrihesha dhe të vallëzoja me të... E, teksa vallëzonim, i ndërruam disa fjalë ndërmjet veti. Më tha se quhej Fatos, se ishte nga Rahoveci, student në Fakultetin Ekonomik. Unë i thashë se quhem Vjollca, nga Fushë-Kosova, punëtoreshë në market, në Prishtinë. I buzëqeshnim njëri-tjetrit plot gaz e hare, por e nuk lejonim ta shfrenonim veten... Dhe, atë natë vetëm u prezantuam, pa i thënë asgjë më shumë njëri-tjetrit. Megjithatë, numrat e telefonit i shkëmbyem ndërmjet veti. Të nesërmen nuk u takuam, por ditën e dytë, pasi u takuam, dolëm kah Mensa e Studentëve, duke ecur dorë për dorë, sikur njiheshim me vite të tëra! Sa flisnim për jetën e përditshme, kalonim te politika,

te kinematografia dhe dalëngadalë i afrohem temës më të rëndësishme për ne – njohjes sonë, e që veç sa kishte filluar... Por, edhe unë isha shumë e matur. I thashë se e dua një njeri me shpirt vetëm atëherë kur e shoh se edhe ai, vërtet, më do, më çmon, më nderon e respekton dhe nuk më tradhton. Se i besoj një mashkulli vetëm atëherë kur hidhet në zjarr për mua. Dhe, po atë ditë u morëm vesh që të njiheshim ndërmjet veti edhe familjarisht.

## NUK MARRË DJALË TJETËR POS TIJ!

Pas ca ditësh ai erdhi në shtëpinë tonë: babai im i doli përpara dhe e ftoi brenda. Në shtëpi ishte me ne edhe nëna e vëllai i madh. Pasi u bëra kafe, babai më pyeti: "Bijë, a po e do ti këtë djalë a ai ty?!". Një copë herë mora frymë rëndë, vështrova nënën time që heshte dhe me një zë krejt të shterur u ktheva kah babai dhe i thashë: "Po, baba, unë tjetër nuk marrë pos tij!". Dhe, pas këtyre fjalëve Fatosi e mori fjalën: "Unë e kam ndërmend të martohem me të, të krijoj familje. Kështu e kam parashikuar të ardhmen time, por jetës nuk i dihet...".

## GJUMI NUK MË ZINTE, BUKA NUK MË HAHEJ!

E hetoja padiktueshëm se dita-ditës e doja më shumë dhe nuk më rrihej dot një ditë e vetme pa e parë. Bile, nganjëherë ndihesha keq: gjumi nuk më zinte, buka nuk më hahej, më lexuar nuk më lexohej, në shtëpi nuk më shkohej! Thënë shkurt, jeta ime ndryshoi krejtësisht dhe nisi dalëngadalë të rrokullisej... Një ditë më tha se dëshiron të ketë diçka kujtim prej meje. Nxora aty për aty unazën e arit nga gishtin, që në ditëlindjen time të pesëmbëdhjetë ma dha nëna dhe ia dhashë. Por, një ditë, pasi u rrokullisëm e u palavitëm në shtratin tonë të dashurisë, pash se kishte një agresivitet të tepruar dhe kjo më bëri të ndihesha keq. Dhe, që nga ajo ditë gjërat ndërmjet nesh ndryshuan... Nisi t'i rrallojë edhe thirrjet telefonike, madje... Kjo më dha të kuptoja se diçka e keqe fshihej, se diçka e trishtueshme me fatin tim po gatuhej... Dhe, dita-ditës, gjithnjë e më rrallë shiheshim, aq sa vendosa t'i them "lamtumirë". Por, nuk ma dha atë mundësi, meqë ai me kohë ia theri në Belgjikë, te familja e tij... E, unaza e nënës sime mbeti në gishtin e tij, apo edhe e ka hedhur, një Zot e di!

V. Limani



**Kompleksi Dardania**  
*Vendi ku fillon një jetë e re!*



+383 49 50 90 90



[www.cimaks.com](http://www.cimaks.com)

A ndodh veç me mua, apo...



# Pse para gruas veshët më rrinë palosur?

## FËMIJA RRAHË PRINDËRIT PSE NUK I JAPIN PARA!

Rri dhe mendoj sa të këqija paska jeta njerëzore në Kosovë. Kurrë nuk i kam numëruar të gjitha. Ra kjo ditë dhe e shoh sa shumë gjëra të këqija paska.

Sepse, teksa pi kafenë e mëngjesit, një burrë që shet telefona mobilë, tregon se si një djalë i rrahë çdo ditë prindërit e vet, duke u kërkuar para për drogë. E, kur ata nuk i japin, u thotë: "Pse nuk keni para?!"

"A jetojnë ata në banesë të lartë apo në shtëpi?", pyet njëri burrin që tregon këtë ngjarje.

"Në shtëpi jetojnë dhe nuk është më e lartë se një kat", u thotë ai.

"Mirë qenka, sepse sot po ndodh gjithçka, po hidhen njerëzit nga katet e larta të banimit. Njeriu sot ka pak vlerë, sepse për shumëkënd më shumë vlerë ka paraja", ia kthen jetri.

## A KA ARDHUR DITA ME I MARRË LAKMI TË VDEKURIT?

Arrij në shtëpi me shumë mendime dhe preokupime dhe gruaja më thotë me të hyrë brenda:

"Çka i ke palosur veshët? Je pa qejf, a?"

Nuk i dhashë përgjigje, por gjeta vend në ballë të sallanit. Ngrihem dhe shikohem në pasqyrë si i kam veshët

dhe a janë palosur a jo, sikur më tha gruaja dhe ajo sërish më pyet a jam mirë...

"Mirë jam, edhe veshët i paskam mirë. E di se duhet të urtohem, sepse sot po ndodh gjithçka dhe duhet ta përdor maksimën e vjetër edhe për kohën e re, meqë qenka e vetmja gjë që ia vlen të ruhet edhe për sot: "Qengji

i butë i thithë dy nëna!". Prandaj, rri urtë e jeto edhe ndonjë ditë! Dikur nuk ishte kështu... Si ta kthej kohën e vjetër?

Babai ka vdekur, por të vdesësh me fytyrë qenka njëfarë lumturie. A e dini si thoshin dikur në oda: "Do vjen një kohë m'i marr lakmi të vdekurit!"

A mos është tash ajo kohë për të cilën flisnin pleqtë dikur?

Selim Rama

Radio, Lajme, Moti, Video, TV, ...  
Vetëm me aplikacionin shkabaj për Android

Google play

Shkabaj  
www.shkabaj.net

# remos® KA PUNË PËR TY!



Çka ne po kërkojmë është: **Pizzamen, Kuzhinier, Barista, Kamarier**



Aplikuesit duhet të kenë njohuri të gjuhës  
Gjermane dhe Angleze

Vendndodhja:  
Frankfurt, Këln, Koblenz, Wiesbaden,  
Westerwald, dhe Urmitz.

Na kontaktoni në [info@remos-restaurants.de](mailto:info@remos-restaurants.de)



remos\_restaurants

| [info@remos-restaurants.de](mailto:info@remos-restaurants.de)

| [www.remos-restaurants.de](http://www.remos-restaurants.de)

# Cili lypës ua prek faqet femrave në Prishtinë?



Derisa pi kafe në rrugën "Vellusha", në Prishtinë, vjen një grua bukur në moshë, shtrin dorën dhe kërkon 10 centë. "10 centë, ju lutem! Vetëm 10!". I kisha dy euro nga një. Ia jap njërin dhe ajo, pasi më falënderon, vazhdon tutje... "10 centë, ju lutem, vetëm 10!", refren ky i përditshëm. Nuk di nga është lypësja, por e shoh shpesh në kafene të ndryshme të Prishtinës. Ndoshta është nga Llapi, sepse ashtu më duket e folmja e saj...

## LYPËSJA ME FËMIJË NË KRAHË

Ndërkohë, vjen edhe një femër tjetër me fëmijë në krah. Nga pamja shihet qartë se është nga Shqipëria, nga atje ku Migjeni mori TBC-në nga refrenet e tillë. Kërkon

para, por nuk shoh se i jep kush... Pas pak vjen një lypsar kosovar, por me stil ndryshe. Shpeshherë të njëjtin e shoh edhe në semaforë dhe. teksa u lypës para femrave shofere, nëpërmjet xhamit të hapur ua prek herë-herë edhe flokët madje edhe faqet... Afrohet afër meje dhe, sikur më njeh që moti, ma qet dorën në qafë dhe më thotë: "M'i jep 50 centë, menjëherë!". Dhe, dikush i jep para nga frika, dikush nga mëshira... "Ja, merri dhe shko!", i thotë njëra. Kryesisht, nga frika i japin para femrat, sidomos vajzat e reja, sepse ai di edhe t'i maltretojë: i prekë në trup, në faqe, në flokë... Ky është lypësi më modern i Prishtinës. E ka gjetur mënyrën si të fitojë, sidomos nga vajzat e reja...

## LYPJA ËSHTË BËRË BIZNES!

Keq, pra, them me vete, derisa pi makiato, 3-4 lypës të sillen përreth dhe s'ke si të pish kafe rehat...

Por, ndalem e mendohem: njeriu nuk e shtrin dorën edhe bash kollaj, pa i ardhur shpirti në majë të hundës...

Por, disa këtë punë e kanë bërë zanat. Bile biznes i mirë! Sepse, dje, derisa prisja të paguaja gjërat e blera në marketin "Emona", afër shkollës fillore "Elena Gjika" në Prishtinë, një lypës ia kishte dorëzuar paratë e imta punëtores në arkë që t'i merrte para në letër. Grushtet me para metali i kishte plot...

S. K.





**PARA**

**PAS**



**20 SEANCA**

**-13 KG**

Qendrat e dobësimi 'Shkenda Dubova' janë ndër bizneset më të suksesshme të vitit. Duke filluar me një degë të vetme në Prishtinë, biznesi i Shkendës sharmante, ka kaluar kufijtë kosovar. Tani, qendrat e dobësimi gjenden edhe në Shqipëri, Gjermani dhe Zvicër, e njëkohësisht pritëse që të hapen edhe nëpër vende të tjera të botës.

Gjithsesi, suksesi i tillë vjen si rezultat i punës së palodhshme të Shkendës dhe stafit të saj, mirëpo edhe i shumë storjeve të suksesit, të qindra klientëve të kënaqur.

Kush thotë që një femër nuk është e denjë për biznes?!

Shkenda Dubova e dëshmon të kundërtën, duke qenë shembulli më i mirë i femrës kosovare të suksesshme.

Shumë mund të pyesin se si ndodhë i gjithë procesi i dobësimi tek këto qendra, me rezultate kaq të dukshme tek klientët? Çdo klient fillon me seancat e shkrirjes së dhjavit, përmes aparaturave më moderne, që janë në përputhje edhe me standardet evropiane të teknologjisë së dobësimi.

Kështu, klienti së pari i nënshtrohet një analize trupore, ku përcaktohen: masa dhjamore, masa hidrike, masa muskulore dhe skeletore, si dhe metabolizmi. Si rezultat i kësaj terapie, klienti humbet 5-8 kg në 10 seanca të plota dobësimi, me një reduktim të perimetrit deri në 10 cm, për vetëm 10 seanca.

I gjithë ky proces ndodhë falë këtyre aparaturave, karakteristikat e të cilave do t'i shohim në vijim:

- Perfect Body-Tunnel Sauna - Është një aparaturë e teknologjisë së fundit, dhe rezultat i një projekti të gjatë kërkimor, efikasiteti i së cilës është verifikuar shkencërisht në të gjitha aspektet mjekësore e teknike, pa efekte anësore, e po ashtu, edhe kuruese për shumë sëmundje. Kjo aparaturë funksionon duke aktivizuar molekulat e ujit, që përmirësojnë thithjen e oksigjenit, qarkullimin e gjakut dhe nxisin metabolizmin. Rrezet infra të kuqe të afërta dhe të largëta, kombinohen për të depërtuar në indet e lëkurës deri në 30% (6 mm nën epidermë), duke shpërbërë grumbullimin e yndyrës të lokalizuar në bark, vithe dhe kofshe. Në mjekësi, IR përdoren për shërimin e shumë sëmundjeve si: sëmundjet reumatike, sëmundjet degjenerative të nyjeve, gjendjet postraumatike (kryesisht sportistët), inflamacionet e hapësirave paranazale etj.
- Body Shape-Kabina e Shtrirë - Një tjetër pajisje që sjellë benefite të jashtëzakonshme për shëndetin, e në veçanti në humbje të peshës. Kjo aparaturë realizon një funksion të rëndësishëm në relaksim dhe detoksifikimin e tyre, duke larguar toksinat dhe acidin laktik. Benefitet kryesore të kësaj aparature janë:

- Riaktivizim metabolizmin dhe ndihmon në eliminimin e shtresave të tepërta dhjamore, duke eliminuar kilogramët, dhe duke ofruar rimodelimin e formës trupore;
- Lehtëson dhimbjet nga patologji të ndryshme, si dhembjen e kurrizit, nervit ishiatik, artritin, reumatizmin;
- Rritë qarkullimin e gjakut duke furnizuar kështu indet dhe çdo pjesë të trupit, me elemente ushqyese;
- Tonifikim i thellë;
- Përmirëson shëndetin e zemrës dhe ulë stresin;
- Përmirëson sistemin nervor;
- Zhdukë në mënyrë të ndjeshme celulitin duke eliminuar shtresat dhjamore;
- Ngadalëson efektin e plakjes, duke përmirësuar dukshëm elasticitetin dhe butësinë e lëkurës;
- Përmirësim i dukshëm i drenimit të toksinave dhe i lëngjeve;
- Detoksifikim i organizmit, rritje e forcës dhe fleksibilitetit;
- Lehtëson gjendjen e depresionit;
- Efekt analgjezik;
- Lehtëson dhimbjen dhe përmirëson lëvizjet te personat që kanë sëmundje reumatike, etj.

• Sauna Tradicionale nga Druri i Pishës - Është aparaturë ku përmes efektit termik të nxehtësisë, ndihmon në eliminim e shtresave dhjamore dhe humbjen e peshës. Disa nga benefitet e saunës me nxehtësi janë:

- Detoksifikim;
- Përmirëson qarkullimin e gjakut dhe ulë tensionin arterial;
- Humbje të peshës;
- Eliminon celulitin edhe nga zonat më delikate;
- Relaksim muskolor, etj.

• Pajisja e Dobësimi Intensiv (Ultra Sonik) - Kjo pajisje funksionon përmes valëve sonike të frekuencës 40000Hz, të gjeneruar nga sonda. Pasi valët hyjnë në trupin e njeriut, gjenerohet efekt intensiv goditës në qelizat dhjamore, si dhe lëvizje ndërmjet qelizave dhjamore, të cilat në mënyrë efektive djegin energji, dhe kështu ndodhë tkurrja e qelizave dhjamore. Ndërkohë, vibrimi i valëve sonike, shkakton ndikim intensiv midis qelizave, të cilat shpërthejnë menjëherë, duke zvogëluar numrin e qelizave yndyrore dhe arrijnë efektin e heqjes së dhjavit.

• Elektrostimulorët Muscular - Ky është procesi i fundit që bëhet gjatë një seance. Është një proces shumë i rëndësishëm, përderisa jeni duke shkrirë dhjavin, përmes elektrostimulimit, tonifikohet trupi, nuk e lë të varet dhe të qulllet trupi, si dhe stimulohen muskujt dhe ngushtohet perimetri.

# Pse m'u dogj zemra kur pash odën e rrënuar?

*Zbrita nga treni atëbotë dhe eca një orë e gjysmë deri në shtëpi. Doja të ngihesha frymë të vendlindjes, sepse më kishte munguar ajri sa e sa vjet. Më kishin munguar edhe bari, edhe malet, edhe kodrat...*

Te "Bregu i mullirit" ngrita kokën ta gjeja odën e babait, me krenarinë e vet hyjnore, por nuk e pash nga pullazi i një shtëpie të re, që ishte ndërtuar afër saj. Mendova se do e shihja posa të afrohesha edhe pak, por kur u afrova pash një gërmadhë, e që ishte mbuluar me bar e therra. Nisa t'i urreja të dyja, përnjëherë, pasi e kishin pushtuar odën e vjetër, ku vinin burra nga të gjitha anët e Kosovës... Ndala hapin dhe mu duk se e shihja babën këmbëkryq, në ballë të odës. Në të djathtë të tij shihja Raif Tashollin, një burrë i gjatë, e që ushtronte zejen e metaleve në bodrumin e shtëpisë. Mjeshtëria kryesore e tij ishte punimi i pushkëve. Raifi i kishte mbajtur 12 vjet burg në Mitrovicë të Sremit, menjëherë pas luftës së Dytë Botërore, sepse ishte për rrënimin e Jugosllavisë.

## BURRI QË I DËGJONTE LAJMET E "RADIO LONDRËS"

Në të majtë të babait shihja Lif Hoxhën, burrin që dëgjonte lajmet e "Radio Londrës", e më tej, nga ai, shihja mikun e shtëpisë, xha Fetahun, babën e të cilit e



kishte vvarë hasmi.

Dhe, një grua e kishte marrë hakun e burrit, duke e kryer aktin e vrasjes, veshur me tesha të burrave.

Në anën e djathtë nga oxhaku shihja Hasanin e Malishevës dhe Nekiun e Prizrenit, e që, më vonë kuptova se ai ishte nga Vermica e kufirit me Shqipërinë.

Në odë e pash edhe patriotin e madh nga Cërnilla e Ferizajt, Brahim Graincën, që kishte mbajtur burg për deklaram për bashkim me Shqipërinë, pikë ku edhe ishin ndarë me Fadil Hoxhën, me të cilin kishin qenë bashkëluftëtarë.

Dhe, secilin burrë që shihja, ishte histori në vete...

Bëj ca hapa në të majtë dhe nën gërmadhë shoh trapazanin e odës, e që ishte gjashtë metra i gjatë dhe i kishte tre metra gjerësi, brenda odës 100 metra katrorë. E, nën trapazan, babai i mbante drurët për stufën e odës...

Silleme tutje dhe dal kah dera e odës, aty ku kanë shkelur pragun mijëra burra e dasmorë. Dhe, më shfaqen para sysh dasmat e gjithë mëhallës, e që bëheshin aty. Në hajatin e odës bëhej çaji dhe buka e dasmave.

## PSE U MËSHONIN SHKELM DYERVE NJERËZIT E UDB-SË?

Tutje dal tek dritarja e madhe prej druri, në të cilën kanë trokitur para mëngjesit shumë herë njerëzit e UDB-së, kur kërkonin të dinin se kush ishte në odë. Babait nuk i pëlqente kur dikush trokiste në dyert e oborrit dhe në xhamin e odës. Thoshte se nuk ishte shenjë e mirë që dikush u mëshonte dyerve të oborrit, pa e thirrur emrin e babait në derë. Dhe, u solla fund e krye odës së vjetër. Mu duk sikur burrat e mëdhenj janë nën gërmadhat e saj. Mu duk sikur fjalët e tyre dhe të bëmat i ruante oda, nëpër kohë...

Mu mbushën sytë lot kur m'u kujtuan gjithë ata burra, e që asnjëri prej tyre më nuk është gjallë. Trarët e një ane të odës ishin plandosur me maja në tokë, e bishti u qëndronte akoma në qiell.

Dhe, pas do viteve ajo do të shembej e tëra. Vetëm gurët e saj ende nuk kishin lëvizur, sepse trashësia ishte gjysmë metri. Andaj, në çast, mu mbushën sytë lot dhe thashë se oda nuk qëndron në këmbë pa burrat e dheut! Sepse, nuk mund t'i ngush-toje për asgjë ata burra...

**Sokol Murturi**



# DENTFIX

ORDINANCA STOMATOLOGIJE

## Misterioze...

*Nuk dihej se nën grumbullin e gurëve kush pushonte në amshim, por dihej se vendi quhej “Varri i hallës”. Kush ishte, në fakt, “halla” dhe kur kishte vdekur? Këtë nuk e dinte askush, madje as legjenda. Ajo ishte parë disa herë pranë varrit dhe i shqetësonte kalmhtarët. Herën e fundit ishte parë në vitin 1999, kur edhe konfrontohet me paramilitarët serbë, të cilët e braktisin shtëpinë ku ishin pozicionuar në pamundësi ta vrisnin “hallën”. Varri tjetër është i një burri që e kishte mallkuar gruaja. Dhe, që nga nata kur kishte dalë nga shtëpia më nuk ishte kthyer në shtëpi.*



# Ku ndodhet varri i burrit që e kishte mallkuar gruaja?

Si fëmijë ruanim bagëtinë në vendin që kishte shumë barë, edhe pse vendi ishte paksa me therra. Në atë vend dominonin trëndafilat e kaçës së egër. Dhe, kur lulëzonin trëndafilat e kaçës së egër, vendit i vinte erë e mirë. E tërë ajo therrishtë, që kishte një diametër rreth njëqind metrash, kishte në qendër një varr, por që nuk i dihej as viti e as stina. Njihej me emrin “Varri i hallës”.

E, kush ishte halla, çfarë emri kishte, askush nuk dinte... Ajo që dihej ishte se i gjithë lokaliteti ishte mbuluar me gurë e mbi të kishin dal therrat. Dhe, po të shkelje në atë vend dora e

hallës mund të të kapte këmbën dhe të të tërhiqte brenda varrit...

Aty-këtu, vetëm ndonjë dhi mund të hynte në therrishtë për të këputur stapët e njomë të kaçave. Por, disa pranverave as dhinë e kuqe nuk kaluan mirë në therrishtë. Fakti që dolën të kafshuara nga gjarpinjtë, e bëri edhe më të tmerrshëm tregimin për “hallën” e varrosur aty. Dy dhi ngordhën nga kafshimi e dy të tjera fituan të ajur në gjinj, për çka u desh të shëroheshin te Nëna Jenë, e cila pasi e shponte pulpin e dhisë me gjilpërë, i rridhte gjaku dhe dilte helmi...

## PSE LOZNM AFËR "VARRIT TË HALLËS"?

Ne, fëmijët e lagjes, e kishim bërë zakon që të gjitha lojërat i loznim afër atij varri. Aq më shumë, aty ishte një lëndinë e gjerë që e pushtonim ne, fëmijët, ndërkaq bagëtia kullosnin jo larg therrishtës.

Gojëdhëna thoshte se nuk ishte mirë të kalohej natën rreth "Varrit të hallës" dhe se ajo ishte një roje e asaj hapësire.

Thuhej se vetëm qeni mund ta shihte lëvizjen e një qenie që sillej natën rreth varrit, por e tëra ishte vetëm legendë...

## SI IKËN KALIMTARËT NË DITËN E PAZARIT?

Ishin disa fshatra përreth, e që, banorët e tyre, për të arritur në shehër, duhej të kalonin pranë "Varrit të hallës". Sidomos të shtunave kishte lëvizje shumë të mëdha të fshatarëve, sepse dilnin në pazar në Ferizaj. Atyre u duhej të kalonin rreth varrit...

Një ditë u bë i bujshëm lajmi i mistershëm se një kalimtar i kishte dal para "halla", e veshur me të bardha dhe ai ishte kthyer prapa, madje duke ikur.

"Me t'u ofruar afër therrishtës, mbi gurë qëndronte një plakë me veshje të bardhë. E pash "hallën" nga larg, por nuk kishte rrugë tjetër kalimi. E ngadalësova hapin, por me t'i hedhur edhe tre-katër hapa të tjerë, "halla" u ngrit. Fillova të frikësohesha.

Por, mendja më shkoi nëse ndonjë shok i fëmijërisë kishte përgatitur ndonjë "shfaqje" të frikësimit...

Por, "halla" u nis drejt meje dhe unë u ndala. Pastaj, u ktheva prapa, duke ia mbathur vrapit me tërë fuqinë që kisha", tregon kalimtari.

Dhe, që prej atëherë, për shumë vjet me radhë, rrugës rreth "Varrit të hallës" më nuk i kishte rënë askush...

## KONFRONTIMI I "HALLËS" ME PARAMILITARËT SERBË

Vit pas viti e gjërat kishin ardhur deri te viti 1999, kur edhe ndodhi lufta në Kosovë. Në atë kohë halla përsëri doli në skenë për të krijuar histori të mistershme.

Jo më larg se 100 metra nga "Varri i hallës" ishte ndërtuar paksa moti një shtëpi, e që banorët e saj kishin ikur nga lufta. Në të ishin vendosur forcat paramilitare serbe dhe natën e ditën shtënin me automatikë në plepat pranë. Me gjasë, ata e kishin trazuar "hallën" në shtëpinë e vet, e cila kishte filluar të konfrontohej me paramilitarët, kryesisht natën. Fillimisht, "halla" nga varri kishte dal me fener në dorë. Roja e paramilitarëve e kishte hetuar dhe shti me armë zjarri në drejtim të saj. Por, ajo nuk rrëzohej në tokë... Forcat paramilitare serbe ishin befasuar se ç'po ndodhte... Dhe, menduan në diçka të mistershme, e që edhe po të shtënin me artileri nuk do e zhduknin. "Halla" hidhte gurë mbi paramilitarët dhe afrohej gjithnjë e më afër tyre, andaj paramilitarët edhe detyrohen të tërhiqen nga ai vend...

Në ikje e sipër, paramilitarët, duke tentuar t'i binin trup rrugës, kishin mbetur në baltën e "Sokakut të keq", ku pizgueri serb realisht mbeti aty deri në muajin korrik të vitit 1999, kur forcat e KFOR-it e nxorën nga balta për ta dorëzuar në muze. Dhe, pas kësaj beteje të "hallës" me paramilitarët, tregimet për "Varrin e hallës" zunë të mos ishin vetëm mitike, por bënë bujë edhe në rrethinë e më gjerë...

Prej vitit 1999 më nuk është krijuar e as dëgjuar asnjë mit për "hallën". Por, edhe kalimtarë në atë pjesë ka gjithnjë e më pak.

Gurët e varrit të saj janë po aty, edhe pse therrina është prerë dhe nuk është ajo që ka qenë dikur. Thuhet se "halla" nuk do të dalë më nga varri deri në një luftë tjetër...

## VARRI I BURRIT QË E MALLKOI GRUAJA...

Prej kohësh, në një lëndinë varresh, ndodhej një varr që quhej "Varri i vetmuar". Quhej kështu, sepse për dalim nga varret tjerë, kurrë nuk kishte vizitorë, as familjarë që i shkonin, të paktën, për Bajram. Pra, ishte një varr batall, që nuk e vizitonte askush. Vit pas viti e kohë pas kohe, për më shumë se 80 vjet, ai varr njihej me emrin "Varri i vetëm". I shkretë, i lënë në harresë.

"Banori" i varrit ishte njeri i mallkuar

nga gruaja e tij. Historiku i këtij mallkimi është i dhimbshëm dhe tronditës: Gruaja që e kishte mallkuar burrin kishte qenë bukuroshe, që e kishin pasur lakmi meshkujt për bukurinë e saj. I ishin ofruar shumë meshkuj bukuroshë, por ajo nuk e kishte pranuar asnjërin. Fakti se kishte shumë të interesuar për të, kishte bërë që jo pak fjalë të kurdiseshin për të.

Dhe, fjalë pas fjale e ditë pas dite, në mungesë të babait, xhaxhai e kishte fejuar për një malësor, i zoti për pushkë e pasuri. Vajza e bukur kishte refuzuar fejesën, por fjala e saj nuk ishte marrë parasysh nga axha i saj. Një ditë, tek bënte punë në fushë, një djalë kalimtar ia hedhë syrin dhe e ngacmon. Ajo i thotë:

"Ec rrugës tënde se jam vajzë me bela!"

"Bela pa bela të kisha marrë për nuse edhe po të bëhen njëqind gjaqe!", ia kthen kalimtari.

"Nëse je ti ai që i rri fjalës pas, merrmë me vete e qomë në shtëpi, por nëse s'je i fjalës më lërë dhe shporru nga këtu!", i thotë vajza.

Djali kalimtar i premtonte se nuk do e lë kurrë në baltë dhe do e merr nuse sipas adetit.

Dhe, ditë pas dite e vit pas viti vajza bëhet nuse e tij. Më pas i lindi dy fëmijë. E privuar nga familja me leqitje, bënte jetë duke u mërzhitur për familjen, të afërmit...

Por, kur e lindi edhe fëmijën e tretë, burri i saj i nisi aventurat, duke u larguar shpesh nga shtëpia. Nusja provon ta ndalë burrin në shtëpi, por ai nuk e përfillë kërkesën e saj. Dhe, një ditë, teksa ai dilte nga shtëpia, gruaja e mallkoi që të mos kthehet më i gjallë...

Ai qëndron dy net te shokët dhe, teksa kthehet në shtëpi, dikush në rrugë i jep plumb në kokë dhe mbetet i vdekur... E varros po i njëjti gjatë natës në varrezat e fshatit, duke ia lënë dy gurë mbi varr.

Kalon një vit dhe varri fillon të rrafshohej. Pra, njihej si varr i dikujt për të cilin nuk interesohet askush...

Gruaja priti me vite që burri t'i kthehej në shtëpi, por kot. Ajo u fliste fëmijëve se babai do kthehej një ditë, por ai kurrë nuk u kthye...

S. M.

## MAGJISTARJA

[lindjavdekja@hotmail.com](mailto:lindjavdekja@hotmail.com)



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

**kontaktoni në këtë email adresë:**

[lindjavdekja@hotmail.com](mailto:lindjavdekja@hotmail.com)

### **Pse më vjen e keqja kur ndihem mirë?**

E dashura magjistare, kam një problem që mendoj se nuk e ka çdo kush. Kur e ndiej veten mirë dhe preku lumturinë, prishet gjithçka. Nuk di a e kam këtë prej Zotit apo prej robotit...

Zoti thotë se fati vjen krejt papritur dhe ashtu më ka ndodhur edhe mua. E njoha një djalë, me të cilin çdo gjë shkoi mirë dhe gjërat filluan të thellohen, duke shkuar çdo ditë e më mirë.

Ndodhi në këtë kohë që atij i vdiq një shok i ngushtë dhe që nga ajo ditë ai nisi të sillet me mua shumë ftohët. Gëzimi im filloi të shndërrohet në dëshpërim. Shkurt, çdo kë që njoh më ndodh kështu!

Dua të di, motër magjistare, a do të del hajr në këtë punë?

**“Pa shifër”**

### **Përgjigje:**

Populli thotë: “Mos u gëzo i gëzuar! Mos u hidhëro i hidhëruar!”. Këto fjalë e shpjegojnë më së miri këtë gjendje të ndryshimeve socio-psikike të njeriut, tek i cili ndodhin ndryshime, sepse jeta është dialektikë.

Andaj, jo gjithnjë jeta shkon sipas parashikimeve. Jeta sjell befasi dhe surpriza. Filozofia popullore rrjedh nga të jetuarit. Ajo që krijon

het në zjarr mbetet për t’u kënduar e jetuar.

Por, në rastin tënd, ia vlen lufta për atë person që të ka dashur. Ai që të ka dashur ka mundësi të të dojë përsëri...

Ju jeni të njëjtit persona, të cilët dashurinë e keni hedhur në aut, shkaku i një vdekje që ka goditur mikun e tij të ngushtë.

Ai ka mundësi të rikthehet te ti me plot dashuri, posa ta kuptojë se jeta e ka edhe anën e dhembjes që është reale, edhe pse vjen papritur.

### **Jam mirë, a jetoj me dhimbje të përditshme!**

Jam një nënë me dy fëmijë (22 dhe 20 vjeç). Jetoj jashtë Kosovës. Jetoj me një shqetësim të përditshëm, duke më dhimbësuar çdo ditë diku. E, kur shkoj te mjeku asgjë nuk më del problem!

Kam bërë analiza sa e sa herë, por çdo gjë e kam mirë, ndërkaq nuk ndihem mirë!

I kam dy djem dhe janë në rrugë të mirë, nuk konsumojnë as duhan e as alkool.

Pse e kam këtë problem, motër e nderuar?

**“Largësia”**

### **Përgjigje:**

Ti, në fakt, nuk e ke këtë problem sot, por kështu ke jetuar që nga

fëmijëria. De fakto, nuk je paciente, por nuk je edhe larg pacientes. Nuk ke asnjë problem, por ke dhimbje që shkaktohen nga baza nervore psikiatrike e që rrjedh nga e kaluara traumatike.

Në rastin tënd nuk bën punë mjekësia, e as jeta klinike, sepse kur je mirë me refleksionet mjekolaboratorike, barërat përjashtohen si zgjidhje. Lufta të mbetet ty, prandaj edhe ka shërim alternativ.

### **A është e ardhmja ime pranë burrit?**

Përrshëndetje, jam një zonjë 35-vjeçare, jetoj në Prishtinë. Kam pasur probleme në jetën time. Një kohë kam jetuar jashtë Kosovës, por nuk kam mundur ta bëj jetë atje, prandaj jam kthyer në vendlindje.

Jam martuar para pesë vitesh. Dua të di si do ta kem jetën time dhe nëse ka mundësi t’me shënoni diçka për të kaluarën time, çka kam gabuar që nuk më ka shkuar jeta mirë...

**“Z.”**

### **Përgjigje:**

Nuk ju shoh pranë burrit që je tani. Ti je martuar me të pa e shëruar plagën nga ndarja me burrin tjetër, që keni jetuar në Gjermani. Prandaj, gabimi qëndron mu aty se, të paktën, edhe dy vjet nuk është dashur të kishit bërë martesë.

Sepse, të martohesh me një burrë, duke vuajtur për tjetrin me të cilin ke jetuar, është krim, meqë nuk e bën të lumtur as burrin e as veten. Të vuash për dikë e ta vësh kokën në jastëk me tjetrin, është jorehabilituese.

Pra, ke bërë hapa të nxituar, ku e ardhmja nuk mundet ta vendos bazën e jetës bashkëshortore. Shoh se së shpejti do të ndaheni.

## Si do të vjen fundi i dashurisë sonë?

Jemi një çift që duhemi shumë, punojmë në një zyrë. Lidhja jonë shkon mirë derisa jemi në punë. Kujdesi i tij ndaj meje është i madh, sa nuk di ta përshkruaj. Është njeriu që i kam dhënë gjithçka nga vetja, por, për çudi, si të largohemi dy-tri ditë pa u parë, bëhet i ftohët ndaj meje! Jemi në lidhje qe dy vjet. Dua ta mbylli këtë dashuri me fejesë, por ai heziton...

A do të ndodhë fejesa mes nesh?

**“Dua fejesë”**

## Përgjigje:

*Te ai është një dyshim për një person, me të cilin ti ke punuar në po atë zyrë katër vjet. I kanë thënë se ke qenë e lidhur me të, prandaj është në ndjekje e sipër të fakteve. Megjithatë, besoj se e keni hapur temën e të kaluarës suaj... Nuk do të keni fejesë dhe lidhja juaj do të zgjat deri kah fundi i vjeshtës dhe do të ndaheni përfundimisht.*

## Babai nuk po pajtohet, a ka magji?

Jam një vajzë, 37-vjeçare, jetoj në Zvicër. Kemi probleme me babanë. Nuk pajtohet me fejesën time. Nuk e do personin që e kam zgjedhur për fat të jetës, edhe pse është shqiptar. Derisa s’e kam gjetur vetëm që nuk më ka larguar nga shtëpia, e tash që e kam gjetur nuk pajtohet!

Nëna po më thotë se ka magji. A është e mundshme? Si të pajtohet me fejesën time?

**“E pikëlluara”**

## Përgjigje:

*Mosha jote i dikton gjërat dhe lëvizjet. Deshe apo nuk deshe, ka qenë një moment vendimtar që të bësh fejesë me këtë person, edhe pse ka qenë i martuar. Fëmijën e*

*tij e ka nëna e vet dhe unë shoh se mund të përshtateni në jetën tuaj. Te ata nuk ka ecur martesë si duhet, prandaj kudo që nuk funksionon diçka duhet t’i vjen fundi... Unë shoh se babai yt ka magji dhe ato mund t’i gjeni në dy vende ku ai fle: në shtëpinë në Maqedoni dhe në banesën ku jeni tash. Kontrollonin rrobat e tij në orman dhe do t’i gjeni disa sende të dyshimta. Ato janë magji. Merrni dhe hidhni jashtë shtëpisë dhe ai do të qetësohet...*

## Çka të bëjmë me të?

Jam djalë. Të shkruaj për dajën tim. Ai është 68- vjeçar. I ka vdekur gruaja, por do të martohet me patjetër, ndërkohë që familja janë kundër. Sjelljet e tij po na bëjnë të dyshojmë se ai është çmendur. Po mundohemi të bashkëpunojmë me të, por ai do vetëm qysh thotë vetë. Na ndihmo ta kalojmë këtë gjendje...

**“Pa shifër”**

## Përgjigje:

*Ai nuk ka luajtur mendsh tash, por ka qenë i tillë prej kohësh, e edhe kur e kishte gruan. Në fund të fundit, nëse gjen grua me të cilën mund ta kalojë jetën e mëtejme, mos e pengoni!*

## Fle ulur!

Zonja magjistare, jam një grua, 38 vjeçe, jetoj jashtë Kosovës. I kam tre fëmijë dhe me asnjërin nuk jam e lumtur. Dy janë martuar dhe njëri është ndarë, tjetri është i martuar me të huajën dhe ma ka thyer zemrën, se edhe vetë jam rritur në mjerim... Më i vogli del natën dhe nuk qan kokën për askënd, duke thënë se unë duhet të jetoj dhe nuk merret me problemet e mia.

## PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: “Kosovarja”, fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

Ka kohë që jam pa vullnet jete. Punoj sa mundem, siguroj vetë për të gjithë shtëpinë, por kot... Kohëve të fundit e kam edhe një problem tjetër. Diçka më shtyp në gjoks dhe më lë pa frymë. Nuk po kam guxim të fle në shtrat, andaj fle ulur!

Çka do të ndodhë me mua?

**“E humbura”**

## Përgjigje:

*Je një grua e mbushur vaj nga e kaluara jote jetësore. Disa gjëra që nuk janë për publik, janë ato që e kanë zyrtësuar jetën tënde dhe të njëjtat i kanë bërë bllok lidhjes tënde me familjen. Pa dashur ta hapim këtë kapitull, dua të them se fëmija që rriten pa baba në shtëpi, por që e kanë babanë, dalin nga kontrolli, qoftë si të dëshpëruar me ty apo me babanë e vet, ndonëse kjo shtresë rinore për me keq edhe mund të kalojnë në konsumatorë droge apo alkooli.*

*Dhe, të pakënaqur me jetën familjare, fëmijët tuaj kanë devijuar shumë dhe ky devijim reflekton te ti si nënë, më shumë se kudo tjetër. Nëna, si stacioni i fundit i fëmijëve, nuk ka ku të shkojë prej fëmijëve. Por, ky raport te ti ka sjell depresion jetësor familjar dhe ndihesh keq.*

*Rasti i shtrëngimit në gjoks mund të ndërlihet me dy probleme: Duhesh bërë ekzaminimet kardilogjike. Dhe, nëse ato dalin në rregull, atëherë bazën duhesh kërkuar në anën besëtytnore të shërimit dhe ta rehatosh veten, të paktën, në kohën e gjumit.*



# SHERWOOD

*Resorts and Hotels*

**SHERWOOD  
EXCLUSIVE KEMER**  
KEMER / ANTALYA

**SHERWOOD  
EXCLUSIVE LARA**  
LARA / ANTALYA

**SHERWOOD  
DREAMS RESORT**  
BELEK / ANTALYA

**TUI BLUE  
BELEK**  
BELEK / ANTALYA

**SHERWOOD  
GREENWOOD RESORT**  
KEMER / ANTALYA

**SHERWOOD  
SUITES RESORT**  
LARA / ANTALYA

[www.sherwoodhotels.com.tr](http://www.sherwoodhotels.com.tr)  
+90 444 88 07